



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.164, datë 05.07.2022

PËR

**“FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS
PËR KANDIDATËT QË KA KANDIDUAR PËR POZICION DREJTUESI, TË
KUALIFIKUAR ME VENDIMIN NR.153, DATË 27.06.2022,
TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 159 pika 2 dhe 190 pika 2, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në pikat 2-7 të nenit 32 dhe në pikat 7-8 të nenit 48, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, në nenin 9 pika 4, të Rregullores “Për miratimin e rregullores mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe pas u njoh me relacionin e propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

- I. Të fillojë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, kualifikuar me vendimin Nr.153, datë 27.06.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:
 1. Ilir Hoxha, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
 2. Kledian Llaho, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
- II. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore për ndjekjen e këtij procesi.

SEKRETA

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

IV. U shpall në Tiranë, sot më 05.07.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR

Alfred Balla

ZV/KRYETAR

Tartar Bazaj

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Bujar Sheshi

ANËTAR

Nurihan Seiti

ANËTAR

Eloida Goxhi

ANËTAR

Esmeralda Keshi

ANËTAR

Ludovik Dodaj

ANËTAR

Zeqir Hoda

ANËTAR

Mirela Bogdani